



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 3

Tiranë – E premte, 23 janar 2015

## PËRMBAJTJA

|                                                         | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 14.1.2015  | Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj..... 29                                                                                                                                                      |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 14.1.2015  | Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të posaçme dhe të shërbimit..... 29                                                            |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 14.1.2015 | Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2015, në njësitë e qeverisjes qendrore..... 31                                                                                                                                                                 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 14.1.2015 | Për rishpërndarje të numrit të punonjësve, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, për vitin 2015..... 34                                                                                                                                                     |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 14.1.2015 | Për një shtesë në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”..... 35                                                                                      |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 14, datë 14.1.2015 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 614, datë 7.9.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe të normave të trajtimit me uniformë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”..... 36                                                         |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 14.1.2015 | Për një ndryshim në vendimin nr. 17, datë 13.1.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e afateve të përdorimit të armëve, të teknikës e të pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe të rregullave për trajtimin e tyre pas heqjes nga armatimi dhe përdorimi”, të ndryshuar..... 42 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 14.1.2015 | Për ndryshimin, nga tokë bujqësore në tokë urbane, truall, të sipërfaqes prej 27.9 ha, në zonën kadastrale nr. 1101, Korçë..... 45                                                                                                                                                         |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 14.1.2015 | Për mbylljen e Akademisë së Arteve, Shkodër..... 48                                                                                                                                                                                                                                        |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 21.1.2015 | Për emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil..... 49                                                                                                                                                                                                              |

**VENDIM****Nr. 8, datë 14.1.2015****PËR MBROJTJEN E SHITESAVE NË  
NEVOJË, PËR EFEKT TË HEQJES SË  
FASHËS SË KONSUMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE DERI NË 300 KWH NË MUAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj, për:

a) familjet, që trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-it, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

b) kryefamiljarët, që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

c) kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie shtetëror ose pension pleqërie fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

ç) familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;

d) të verbrit;

dh) personat paraplegjikë e tetraplegjikë.

2. Kompensimi, për familjet që do të kompensohen, sipas pikës 1, të këtij vendimi, bëhet vetëm për 1 (një) kontratë të energjisë elektrike dhe jepet vetëm një herë për një familje, pavarësisht se ato mund të kenë në përbërje edhe të punësuar të tjerë në sektorin buxhetor, të cilët kanë pagë nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, apo persona të paaftë a invalidë, persona që përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti apo ndihmë ekonomike.

3. Përfituesit, që kompensohen për të përballuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike, si rezultat i heqjes së fashës deri në 300 Kwh, sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të përcaktohen nga institucionet përkatëse në të cilat ata marrin pagën, pensionin dhe përfitimet e tjera, kundrejt deklaramit të tyre personal. Marrja e përfitimit pa deklaram dhe kundrejt deklaramit të rremë përbën shkelje administrative, përkatësisht për dhënësin dhe për përfituesin e kompensimit. Në këtë rast, institucioni përkatës zbaton dispozitat ligjore në fuqi.

4. Përfituesi i kompensimit, në zbatim të pikës 3, të këtij vendimi, detyrohet ta kthejë përfitimin e padrejtë dhe përjashtohet, përgjithmonë, nga e drejta e përfitimit të kompensimit për energjinë elektrike.

5. Masa e kompensimit, për çdo përfitues, është 648 (gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë në muaj dhe efekti financiar të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, miratuar për ndihmën ekonomike.

6. Rregullat e veçanta të përfitimit të pagesës dhe të zbatimit të skemës së kompensimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave, ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.1.2015.

**KRYEMINISTRI****Edi Rama****VENDIM****Nr. 9, datë 14.1.2015****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,  
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT PËR  
HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E  
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË  
POSAÇME DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të posaçme dhe të shërbimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**MARRËVESHJE**

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT MBI  
HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E  
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË POSAÇME  
DHE TË SHËRBIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e shtetit të Kuvajtit, më poshtë të quajtura “palët kontraktuese”,

Me dëshirën e lehtësimit të hyrjes, daljes dhe lëvizjes së shtetasve të tyre,

kanë rënë dakord si më poshtë:

## Neni 1

Kjo marrëveshje zbatohet për llojet e mëposhtme të pasaportave:

1. Për Republikën e Shqipërisë: për pasaporta diplomatike dhe shërbimi;

2. Për shtetin e Kuvajtit: për pasaporta diplomatike dhe të posaçme.

## Neni 2

Shtetasit e të dyja palëve kontraktuese, mbajtës të pasaportave të llojeve, të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, hyjnë në territorin e palës tjetër kontraktuese pa viza dhe qëndrojnë për një periudhë maksimale prej 90 ditësh brenda 180 ditëve nga dita e hyrjes.

## Neni 3

1. Shtetasit e palëve kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, të punësuar në misione diplomatike dhe konsullore, dhe në organizata ndërkombëtare me seli në territorin e palës tjetër kontraktuese, kanë të drejtë të hyjnë pa vize në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen edhe për anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta në të

njëjtën familje dhe janë mbajtës të pasaportave të vlefshme të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje.

## Neni 4

Shtetasit e njëres palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, hyjnë, largohen dhe lëvizin transit në territorin e palës tjetër kontraktuese në çdo pikë kufitare të përcaktuar për lëvizje ndërkombëtare.

## Neni 5

1. Shtetasit e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, respektojnë ligjet dhe rregullat e tjera të palës tjetër kontraktuese gjatë qëndrimit në territorin e kësaj pale.

2. Kjo marrëveshje nuk i kufizon të drejtat e palëve kontraktuese për të refuzuar hyrjen ose për të mohuar qëndrimin e një personi të palës tjetër të cilin ajo e konsideron person *non grata*.

## Neni 6

1. Me synimin mbrojtjen e sigurisë kombëtare, paqes dhe rendit publik dhe shëndetin e qytetarëve të tyre, palët kontraktuese kanë të drejtë të pezullojnë, pjesërisht ose plotësisht, zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Pala kontraktuese informon menjëherë palën tjetër në lidhje me vendimin për pezullimin e kësaj marrëveshjeje, pjesërisht ose plotësisht, ose për rihyrjen e saj në fuqi nëpërmjet kanaleve diplomatike.

## Neni 7

1. Palët kontraktuese shkëmbejnë specimene të pasaportave përkatëse të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën për ndryshimin e specimeneve, 60 ditë para hyrjes së ndryshimit në fuqi.

3. Palët kontraktuese shkëmbejnë specimene të pasaportave të reja ose të ndryshuara të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë të dhëna në lidhje me përdorimin e tyre 60 ditë përpara prezantimit të specimeneve.

## Neni 8

Mosmarrëveshjet, që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.



## Neni 9

Marrëveshja mund të zgjidhet me pëlqimin e të dyja palëve kontraktuese. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi në përputhje me procedurat e përmendura në nenin 11 të kësaj marrëveshjeje.

## Neni 10

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të papërcaktuar kohe. Secila nga palët kontraktuese mund ta përfundojë marrëveshjen në çdo kohë, me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja përfundon së zbatuari 90 ditë nga data e marrjes së njoftimit nga pala tjetër kontraktuese.

## Neni 11

Marrëveshja hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se janë përmbytur të gjitha kushtet e parashikuara në legjislacionin e tyre kombëtar, për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Kuvajt, më 19.11.2014, në dy kopje origjinale në shqip, arabisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë të barasvlershme. Në rast interpretimesh të ndryshme, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

**Ditmir Bushati**

Ministër i Punëve të Jashtme

Për qeverinë e shtetit të Kuvajtit:

**Sabah Khaled Al-Hamad Al-Sabah**

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme

**VENDIM**

**Nr. 11, datë 14.1.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË  
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË  
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2015, NË  
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2015, në njësitë e qeverisjes qendrore është 923 veta, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përjashtimisht, për punonjësit e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), Drejtorisë së Dëshmipërblimit të ish-të Përndjekurve Politikë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave, nuk zbatohet pika 3, e vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

3. Përjashtimisht, për Qendrat e Transferimit të Teknologjisë (QTTB), në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, për shkak të veçorisë së punës, pagesa e punonjësve të kontraktuar përlllogaritet sipas volumit të punës së kryer dhe paguhet sipas preventivit përkatës.

4. Përjashtimisht, punonjësit, të cilët merren me anketime të ndryshme të Institutit të Statistikës, punonjësit që përfshihen në procesin zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, instruktorët e Qendrave të Formimit Profesional, si dhe mësuesit në dispozicion në arsimin parauniversitar dhe arsimin profesional, nuk përfshihen në këtë vendim. Miratimi i numrit të këtyre punonjësve, afatet kohore dhe të tjera specifikime, për kontraktimin me kohë të pjesshme të tyre, bëhen sipas udhëzimit të përbashkët të institucionit qendror përgjegjës dhe Ministrisë së Financave.

5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi fillojnë pas hyrjes në fuqi të tij. Përjashtimisht, për punonjësit e përfshirë në pikën 1 të vendimit, të cilët kanë qenë të miratuar, deri në fund të vitit paraardhës, me vendimin nr. 35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2014”, të ndryshuar, efektet financiare fillojnë në datën 1 janar 2015.

6. Efektet financiare për punonjësit e kontraktuar të përballohen nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2015, të njërive të qeverisjes qendrore. Përjashtimisht, efektet financiare për punonjësit e kontraktuar për QTTB-të, Shtëpinë e Pushimit, Durrës (të MPB-së), Shtëpinë e Pushimit të SHISH-it dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit,



ndërsa, për punonjësit e kontraktuar për ALUIZNI-n dhe qendrat e formimit profesional, të përballohen pjesërisht nga të ardhurat dhe pjesërisht nga fondet buxhetore, të miratuara për vitin 2015. Për punonjësit, që përfshihen në procesin zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të përballohen nga fondi i miratuar për zgjedhjet e pushtetit vendor.

7. Ngarkohen ministritë dhe institucionet buxhetore, sipas lidhjes nr. 1, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve, brenda kriterëve të vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

### Lidhja nr.1

| Emri i institucionit                                                           | Nr. i punonjësve | Emërtesa                          | Koha ditore | Periudhë kohore           |
|--------------------------------------------------------------------------------|------------------|-----------------------------------|-------------|---------------------------|
| <b>1. Institucioni i Kuvendit</b>                                              | <b>10</b>        |                                   |             |                           |
| Sektori i botimeve parlamentare                                                | 2                | specialistë redaktimi             | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Sektori i arkivit të dokumentacionit parlamentar                               | 1                | punonjës arkiv/protokoll          | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Sektori për digitalizimin e fondit arkivor                                     | 1                | operator                          | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Sektori i etnikës audio-video                                                  | 2                | specialistë audio-video           | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Shërbimi i mirëmbajtjes së centraleve telefonike                               | 1                | teknik i mirëmbajtjes             | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Shërbimi i mirëmbajtjes së zyrave zgjedhore të qarkut                          | 1                | teknik i mirëmbajtjes             | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Shërbimi i financës për procesin e inventarizimeve                             | 2                | specialiste                       | 8 orë/ditë  | janar-mars; tetor-dhjetor |
| <b>2. Aparati i Kryeministrit</b>                                              | <b>29</b>        |                                   |             |                           |
| Aparati i Kryeministrit                                                        | 26               | operatorë                         | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Aparati i Kryeministrit                                                        | 3                | specialistë                       | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| <b>3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë e Sipërmarrjes</b>             | <b>14</b>        |                                   |             |                           |
| Aparati                                                                        | 2                | sanitarë                          | 4 orë/ditë  | vjetore                   |
| Aparati                                                                        | 1                | nëpunës roje                      | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Qendra Kombëtare e Licencimit                                                  | 1                | sanitar                           | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Qendra Kombëtare e Regjistrimit                                                | 1                | punonjës arkiv/protokoll          | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Qendra Kombëtare e Regjistrimit                                                | 1                | teknik i mirëmbajtjes             | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Përgjithshme e Standardeve                                         | 1                | sanitar                           | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Përgjithshme Patentave, Markave                                    | 1                | sanitar                           | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Përgjithshme Patentave, Markave                                    | 1                | operatorë                         | 5 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja Përgjithshme Metrologjisë (Qendër/Rajone)                            | 5                | sanitarë                          | 4 orë/ditë  | vjetore                   |
| <b>4. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave</b> | <b>128</b>       |                                   |             |                           |
| QITB Vlorë                                                                     | 18               | punëtorë fushe /roje/mirëmbajtës  |             | vjetor -sipas preventivit |
| QITB Lushnjë                                                                   | 14               | punëtorë fushe / mirëmbajtës      |             | vjetor -sipas preventivit |
| QITB Lushnjë                                                                   | 4                | punëtorë fushe                    |             | vetëm periudha pik        |
| QITB Korçë                                                                     | 8                | punonjës blegtorie                |             | vjetor -sipas preventivit |
| QITB Korçë                                                                     | 6                | roje objekti                      |             | vjetor -sipas preventivit |
| QITB Korçë                                                                     | 9                | punëtorë fushe / mirëmbajtës      |             | vjetor -sipas preventivit |
| QITB Korçë                                                                     | 5                | teknikë të mesëm                  |             | vjetor -sipas preventivit |
| QITB Korçë                                                                     | 6                | punëtorë fushe                    |             | vetëm periudha pik        |
| QITB Shkodër                                                                   | 12               | punëtorë fushe /roje/mirëmbajtës  |             | vjetor -sipas preventivit |
| QITB Shkodër                                                                   | 3                | punëtorë fushe                    |             | vetëm periudha pik        |
| QITB Fushë-Krujë                                                               | 13               | punëtorë fushe / roje/mirëmbajtës |             | vjetor -sipas preventivit |
| QITB Fushë-Krujë                                                               | 9                | mekanizator/teknik                |             | vjetor -sipas preventivit |
| QITB Fushë-Krujë                                                               | 2                | punëtorë fushe                    |             | vetëm periudha pik        |
| Ajencia Kombëtare e Duhan Cigareve                                             | 12               | punëtorë fushe/mirëmbajtës        |             | vjetor -sipas preventivit |
| Ajencia Kombëtare e Duhan Cigareve                                             | 3                | teknikë të mesëm                  |             | vjetor -sipas preventivit |
| Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve                                           | 4                | teknikë të mesëm                  | 4 orë/ditë  | vjetore                   |
| <b>5. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës</b>                          | <b>8</b>         |                                   |             |                           |
| Aparati                                                                        | 1                | specialist arkivist               | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Instituti i Transportit                                                        | 1                | sanitar                           | 5 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Inspektimit Hekurudhor                                             | 1                | sanitar                           | 3 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Përgjithshme e Ujësllës-Kanalizimeve                               | 1                | sanitar                           | 4 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Përgjithshme e Ujësllës-Kanalizimeve                               | 1                | punonjës arkivi                   | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Përgjithshme Detare                                                | 1                | sanitar                           | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Përgjithshme Detare                                                | 1                | roje                              | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Përgjithshme Detare                                                | 1                | specialist kapitenerie            | 8 orë/ditë  | qershor-shtator           |
| <b>6. Ministria e Drejtësisë</b>                                               | <b>11</b>        |                                   |             |                           |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare                                                   | 5                | specialistë                       | 8 orë/ditë  | 01/1-01/4/2015            |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare                                                   | 4                | operatorë                         | 8 orë/ditë  | 01/1-01/4/2015            |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare                                                   | 1                | korrektor                         | 8 orë/ditë  | 01/1-01/4/2015            |
| Qendra e Publikimeve Zyrtare                                                   | 1                | korrier                           | 8 orë/ditë  | 01/1-01/4/2015            |
| <b>7. Ministria e Financave</b>                                                | <b>68</b>        |                                   |             |                           |
| Aparati i Ministrisë                                                           | 2                | punonjës prot./arkiv              | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Aparati (Drejtorja e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve CFCEU)       | 1                | punonjës prot./arkiv              | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Drejtorja e Pagesave të Ish-të Përndjekurve Politikë                           | 4                | specialistë                       | 8 orë/ditë  | vjetore                   |
| Aparati i Ministrisë                                                           | 2                | sanitarë                          | 6 orë/ditë  | vjetore                   |
| Aparati i Ministrisë                                                           | 11               | specialistë                       | 8 orë/ditë  | 6- maj                    |



|                                                                     |            |                                  |            |                            |
|---------------------------------------------------------------------|------------|----------------------------------|------------|----------------------------|
| Aparati i Ministrisë                                                | 1          | teknik i mesëm                   | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Aparati i Ministrisë                                                | 1          | pun. mirëmbajtje                 | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave     | 5          | specialistë                      | 8 orë/ditë | vjetore                    |
| Ajencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara/Konfiskuara     | 1          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Degët e Thesarit                                                    | 7          | sanitarë                         | 3 orë/ditë | vjetore                    |
| Dega e Thesari Tiranë                                               | 3          | nëpunës informacioni/roje        | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Drejtoria Përgjithshme Tatimeve/drejtoritë rajonale                 | 13         | punonjës prot./arkiv             | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Drejtoria Përgjithshme Tatimeve/drejtoritë rajonale                 | 2          | operatorë                        | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Drejtoria Përgjithshme Tatimeve/drejtoritë rajonale                 | 1          | pun. mirëmbajtje                 | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Drejtoria Përgjithshme Tatimeve/drejtoritë rajonale                 | 1          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Drejtoria Përgjithshme Doganave/degët doganore                      | 8          | pun. mirëmbajtje                 | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Drejtoria Përgjithshme Doganave/degët doganore                      | 5          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| <b>8. Ministria e Arsimit dhe Sportit</b>                           | <b>42</b>  |                                  |            |                            |
| Drejtoritë Rajonale Arsimore                                        | 13         | sanitarë                         | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Zyrat Rajonale Arsimore                                             | 25         | sanitarë                         | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Ajencia Kombëtare e Provimeve                                       | 1          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Inspektorati Shtetëror i Arsimit                                    | 1          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Ajencia Publike Akreditimit Arsimit të Lartë                        | 1          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Ajencia e Shërbimeve të Sportit                                     | 1          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| <b>9. Ministria e Shëndetësisë</b>                                  | <b>18</b>  |                                  |            |                            |
| Spitali Psikiatrik Elbasan                                          | 2          | kaldaistë                        | 8 orë/ditë | janar-mars; nëntor-dhjetor |
| Drejtoria e Shëndetit Publik Korçë                                  | 2          | kaldaistë                        | 8 orë/ditë | janar-mars; nëntor-dhjetor |
| Aparati i Ministrisë                                                | 1          | nëpunës informacioni             | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| Aparati i Ministrisë                                                | 1          | sanitar                          | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| Aparati i Ministrisë                                                | 3          | operatorë                        | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| Inspektorati Shëndetësor qendror/rajonal                            | 2          | receptionistë                    | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| Qendra Kombëtare e Kontrollit të Gjaktit                            | 1          | receptioniste                    | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| Qendra Kombëtare e Kontrollit të Gjaktit                            | 2          | operatorë                        | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| Qendra Kombëtare Biomjekësore                                       | 1          | operatorë                        | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| Qendra Kombëtare e Zhvillim/Rehabilitim Fëmijës                     | 1          | operatorë                        | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| Qendra Kombëtare Cilësisë dhe Akreditimit                           | 1          | operatorë                        | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| Qendra Edukimit në Vazhdim                                          | 1          | operatorë                        | 8 orë/ditë | 1/1/-31/6/2015             |
| <b>10. Ministria e Punëve të Jashtme</b>                            | <b>12</b>  |                                  |            |                            |
| Sektori i Legalizimeve                                              | 3          | preparatorë                      | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Sektori i Arkivit                                                   | 3          | arkivistë                        | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Sektori i Shërbimeve                                                | 1          | shpërndarës poste                | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Sektori i Shërbimeve                                                | 1          | punonjës mirëmbajtje (lulishtar) | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Sektori i Shërbimeve                                                | 1          | sanitar                          | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Sektori i Shërbimeve                                                | 2          | punonjës mirëmbajtje             | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Sektori i Shërbimeve                                                | 1          | elektricit                       | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| <b>11. Ministria e Punëve të Brendshme</b>                          | <b>115</b> |                                  |            |                            |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 4          | kuzhinierë                       | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 4          | ndihmëskuzhinierë                | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 30         | kamerierë                        | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 13         | punëtorë restoranti              | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 1          | teknik                           | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 6          | receptionistë                    | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 12         | punëtor gjelbërimi               | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 10         | punëtor kuzhine                  | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 25         | punëtor hoteli                   | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 1          | elektricit                       | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 1          | hidraulik                        | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 3          | lavanteri                        | 8 orë/ditë | 1/6-10/9/2015              |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 2          | punëtor restoranti               | 8 orë/ditë | mars-maj; tetor-dhjetor    |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 2          | punëtor gjelbërimi               | 8 orë/ditë | mars-maj; tetor-dhjetor    |
| Shtëpia e Pushimit Durrës                                           | 1          | punëtor hoteli                   | 8 orë/ditë | mars-maj; tetor-dhjetor    |
| <b>12. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë</b>                | <b>35</b>  |                                  |            |                            |
| Aparati                                                             | 1          | sanitar                          | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Aparati                                                             | 1          | nëpunës informacioni             | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Ajencia e Arsimit dhe Formimit Profesional                          | 1          | sanitar                          | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Drejtoria e Shërbimit Kombëtar të Rinisë                            | 1          | sanitar                          | 6 orë/ditë | vjetore                    |
| Administrata Qendrore e SHSSH-së                                    | 1          | punëtor mirëmbajtje              | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, Shkodër, Gjirokastrë, Fier, Kavajë   | 5          | mjekë                            | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, Shkodër, Gjirokastrë, Fier, Kavajë   | 5          | sanitarë                         | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Shtëpia e të moshuarve Tiranë                                       | 2          | kujdestarë                       | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Shtëpia e Foshnjës Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë         | 5          | mjekë                            | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Shtëpia e Fëmijëve Parashk. Shkodër                                 | 1          | mjek                             | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Shtëpia e Fëmijëve shkollor Tiranë                                  | 1          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Shkodër, Sarandë                        | 2          | mjekë                            | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Qendra e Zhvillimit Tiranë, Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë dhe Berat | 6          | mjekë                            | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Qendra e Zhvillimit Tiranë                                          | 1          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Qendra Polivalente Përkujdesjes Sociale, Polican                    | 1          | mjek                             | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Qendra e Trajtim të Viktimave të Dhunës në Familje                  | 1          | sanitar                          | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| <b>13. Prokuroria e Përgjithshme</b>                                | <b>10</b>  |                                  |            |                            |
| Prokuroritë e Apelit dhe Rretheve                                   | 10         | sanitarë                         | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| <b>14. Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor</b>                | <b>16</b>  |                                  |            |                            |
| Gjykatat e Apelit dhe Rretheve                                      | 6          | sanitarë                         | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Gjykatat e Apelit dhe Rretheve                                      | 5          | nëpunës gjyqësorë                | 4 orë/ditë | vjetore                    |
| Kolegji Zgjedhor                                                    | 3          | sekretarë gjyqësorë              | 8 orë/ditë | 6-muj                      |



|                                                             |            |                                    |            |                         |
|-------------------------------------------------------------|------------|------------------------------------|------------|-------------------------|
| Kolegji Zgjedhor                                            | 2          | nëpunës gjyqësorë                  | 8 orë/ditë | 6-muaj                  |
| <b>15. Avokati i Popullit</b>                               | <b>2</b>   |                                    |            |                         |
| Avokati i Popullit                                          | 1          | sanitar                            | 4 orë/ditë | vjetore                 |
| Avokati i Popullit                                          | 1          | punëtor mirëmbajtje                | 4 orë/ditë | vjetore                 |
| <b>16. Autoriteti i Konkurrencës</b>                        | <b>2</b>   |                                    |            |                         |
| Autoriteti i Konkurrencës                                   | 1          | technik të mesëm                   | 6 orë/ditë | vjetore                 |
| Autoriteti i Konkurrencës                                   | 1          | punonjës protokoll/arkivi          | 6 orë/ditë | vjetore                 |
